



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 59, Datë 20.02.2026

MBI

PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 36, DATË 04.02.2026 “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË “HYDRO POWER PLANT OF KORCA” SH.P.K. ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 38, DATË 05.04.2012”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 95 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 7, 8 dhe 9 të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453/2 prot., datë 18.02.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi përfundimin e procedurave administrative të nisura për heqjen e licencave të shoqërive “HEC TRESKA” sh.p.k., “HYDRO POWER PLANT OF KORCA” sh.p.k. dhe “PESHKU-PICAR 1” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 36, datë 04.02.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 154, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HYDRO POWER PLANT OF KORCA” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 38, datë 05.04.2012.
- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare të ERE-s, rezulton se shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj brenda afatit 30-ditor të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së saj.
- Në nenin 9, gërma “a” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”; parashikohet se: Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës.
- Në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.
- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë “HYDRO POWER PLANT OF KORCA” sh.p.k. Vërtetimi i pagesës së

prapambetur konfirmon se nuk ekzistojnë kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk ekziston më.

- Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të bordit të ERE-s nr. 36, datë 04.02.2026. Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin nr. 36, datë 04.02.2026 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 154, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HYDRO POWER PLANT OF KORCA” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 38, datë 05.04.2012”.
2. Të shfuqizojë vendimin e bordit nr. 36, datë 04.02.2026.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “HYDRO POWER PLANT OF KORCA” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI